



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština -Municipality of Prishtina**



## **E K S T R A K T I I P R O C E S V E R B A L I T**

**të mbledhjes së tetë të Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 02.10.2015,  
e cila filloi në orën 15:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Halim Halimi, kryesues i Komitetit, Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, Sami Hamiti, shef i GP të LDK-së, Hazir Borovci, përfaqësues i LDK-së, Besa Rafuna, përfaqësuese e LDK-së, Qëndron Kastrati, shef i GP të LVV-së, Hatixhe Hoxha përfaqësuese e LVV-së, Lirak Çelaj, shef i GP të PDK-së, Laura Zherka, përfaqësuese e PDK-së dhe Islam Pacolli, shef i GP të AKR-së.

**Munguan:** Imer Rusinovci, shef i GP të AAK-së, Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik KDTP.

**Morën pjesë edhe:** Agim Salihu, këshilltar i kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Mejrushe Sejfullahu dhe Nazife Krasniqi, përfaqësuese nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Arianit Osmani nga OSBE-ja, Shemsi Kelmendi, Bujar Demjaha, Shkurta Pacolli, Sylejman Daku, Beqir Berisha, Venera Haxhaj-Lajqi dhe Ibadete Bugari-Mustafaj, përfaqësues nga Kompania "Infra Plus", Valentina Abazi nga INPO dhe Shkëlqim Osmani, Ejona Burrja dhe Driton Muriqi nga Kompania "Vizion Projekt".

Mbledhjen e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues i Komitetit.

Para se të fillonin diskutimet rreth pikave të rendit të ditës, **Lirak Çelaj** propozoi që të shtohen edhe tri pika të rendit të ditës:

1. Kërkesa e komunitetit protestant për ndarjen e një parcele për varreza dhe kishën protestante;
2. Raporti i Auditorit të Përgjithshëm;
3. Raporti i dytë tremujor financiar.

Lidhur me pikat që kanë të bëjnë me Drejtorinë e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, ai paraqiti qëndrimin e PDK-së, që të mos diskutohen derisa të mos ndërrohet drejtori i kësaj drejtorie, z. Liburn Aliu.

Po ashtu parashtroi pyetjen se kush ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhje të KPF-së, dhe a ka evidencë për pjesëmarrësit në mbledhje. Ai propozoi që të jetë evidenca e pjesëmarrësve në mbledhje.

**Kryesuesi** theksoi se sa i përket shtimit të pikave për raportin e dytë tremujor financiar dhe raportin e Auditorit të Përgjithshëm, është obligim ligjor që të sillen në KPF, e pastaj në Kuvend.

**Dardan Sejdiu** dha sqarime lidhur me rendin e ditës dhe për pikat e propozuar për t'i futur në rendin e ditës.

**Sami Hamiti** propozoi që të futen në rendin e ditës tri pikat e propozuara nga z. Çelaj. Ai shprehu mendimin se vitin e kaluar dhe sivjet, Kryetari buxhetet i ka pasur me emërtimet e drejtorive, andaj vetëm të zotohen për atë që e kanë qitur në letër dhe do të shkojnë përpara, por nëse sillen vendimet kështu si janë, nuk do t'i diskutojmë.

Ai sugjeroi që t'i ndërrojnë ato vendime, t'i sjellin me drejtori tjetër dhe në Kuvend do t'i trajtojmë, por nëse janë me këtë drejtori nuk do t'i trajtojmë fare.

**Qëndron Kastrati** propozoi që të ndërmerren masa për peticionin e banorëve të lagjes "Prishtina e Re" lidhur me Planin urbanistik, ndërsa sa i përket raportit të Auditorit të Përgjithshëm dhe raportit financiar tremujor, Kryetari ka obligim t'i njoftojë asamblistët, dhe ato në mënyrë elektronike i ka përcjellë. Sa i përket pikave të Drejtorisë së Urbanizmit, ato duhet të shkojnë në Kuvend.

**Lirak Çelaj** shprehu mendimin se sa i përket peticionit të banorëve të lagjes "Prishtina e Re", nëse është shkelur ligji, është organi që merret me këtë çështje. Ai tha se arsyeja pse po kërkoj të dihet kush merr pjesë në mbledhje, është se po dalin shumë thashetheme të pasakta.

**Sami Hamiti** kërkoi nga nënkryetari zbatimin e vendimet, duke thënë që përgatitni vendimet për Kuvend dhe do t'i trajtojmë, por nëse sillen nga tjetër drejtori e jo nga kjo, siç është tash.

**Dardan Sejdiu** theksoi se Drejtoria e Urbanizmit nuk do t'i trajtojë këto tema, por derisa të vijnë nga drejtoria përkatëse këto i sjell Kryetari i Komunës.

**Kryesuesi** kërkoi të punohet me këtë rend dite, nëse jo, me lejen e nënkryetarit, të futen edhe tri pikat e propozuara, propozimet vijnë nga ekzekutivi.

**Qëndron Kastrati** nuk u pajtua që të shkojë pika për varrezat dhe kishën ortodokse, sepse nuk lejojnë të jenë varrezat e ndara. Njëherësh ai e parashtroi çështjen e dëmeve që ia shkaktonte "Zajednica" qytetit të Prishtinës.

**Islam Pacolli** diskutoi rreth pikave të rendit të ditës, duke thënë se po propozohet të shtohen edhe 3 pika të rendit të ditës, i cili ka 15 pika, në rregull, por kur po kemi shumë pika të rendit të ditës, pikat e fundit nuk po trajtohen mirë.

**Kryesuesi** propozoi që të shkojnë pikat për Kuvend, vendimet e fundit të korigjohen, të jenë unike, sipas emërimit të drejtorive, ndërsa pikat e fundit të mbesin për mbledhjen e radhës.

Ai përsëriti mendimin e tij se para se të mbahet mbledhja e KPF-së, duhet të mbajnë takim shëfat e GP-ve dhe t'i diskutojnë këto çështje para se të vijnë në mbledhje, në mënyrë që të dalin sa më parë nga ky bllokim i punëve.

**Laura Zherka** kërkoi që të sillen vendimi i Kryetarit për emërtimin e drejtorive, në mënyrë që të zhbllokohen këto punë.

**Dardan Sejdiu** dha sqarime për këtë, duke thënë se brenda dy javësh do të bëhet vendimi për emërtimin e drejtorive.

**Lirak Çelaj** tha se tri pikat do t'i propozoj në mbledhjen e ardhshme. Për pikën të cilën e propozoi Qëndroni, nëse është fjala për Prishtinën, ta diskutojnë si asamblistë.

**Hazir Borovci** u shpreh për futjen e pikave në rend dite, pastaj trajtohen apo jo, ai është qëndrimi i tyre politik.

**Kryesuesi** citoi nënkryetarin, se brenda dy javësh do ta sjellin vendimin për organizimin e drejtorive, nëse ai vendim bëhet para mbledhjes së Kuvendit, atëherë do t'i trajtojmë.

**Kryesuesi** propozoi që të punohet sipas rendit të ditës.

#### **RENDI I DITËS:**

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së shtatë;
2. Propozimvendimi për miratimin - lënie në dispozicion për diskutim publik të Planit rregullues të lagjes "Mati2",
3. Propozimvendimi për miratimin e plotësimit dhe ndryshimit të Planit rregullues të lagjes "Sofalia";
4. Propozimvendimi për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues të lagjes "Tophane",
5. Propozimvendimi për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues të lagjes "Dodona",
6. Propozimvendimi për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues të lagjes "Pejton",
7. Propozimvendimi për miratimin - lënie në dispozicion për diskutim publik të Planit rregullues të lagjes "Kodra e Trimave1",
8. Propozimvendimi për miratimin - lënie në dispozicion për diskutim publik të Planit rregullues të lagjes "Kalabria";
9. Propozimvendimi për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues të lagjes "Mati 1";
10. Propozimvendimi për dhënien e pëlqimit për ndryshime në infrastrukturë në një pjesë të Planit rregullues të lagjes "Lakërishta" në Prishtinë;
11. Rikategorizimi i parkut regjional natyror "Gërmia" në kategori - Peizazh i mbrojtur "Gërmia";
12. Propozimrregullorja për punën në institucionet edukativo-arsimore;
13. Caktimi i komisionit për përzgjedhjen e kryetarëve të Bashkësive lokale;
14. Caktimi i anëtarëve të grupit punues për plotësimin dhe hartimin e Rregullores për bashkësi lokale;
15. Të ndryshme.

**Pika e parë**

**Kryesuesi** konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së shtatë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

U konstatua që pikat e rendit të ditës 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, që kanë të bëjnë me Drejtorinë e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit të dërgohen për shqyrtim në Kuvend, vetëm nëse ekzekutivi sjell një vendim për themelimin e drejtorive të reja.

### **Pika njëmbëdhjetë**

**Rikategorizimi i parkut regional natyror "Gërmia" në kategori - Peizazh i mbrojtur "Gërmia".**

**Dardan Sejdiu** informoi se Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor ka dhënë pëlqimin për rikategorizimin e parkut regional natyror "Gërmia" në kategori - Peizazh i mbrojtur "Gërmia".

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah rikategorizimi i parkut regional natyror "Gërmia" në kategori - Peizazh i mbrojtur "Gërmia" dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.**

### **Pika e dymbëdhjetë**

**Propozimrregullorja për punën në institucionet edukativo-arsimore.**

**Dardan Sejdiu** tha se rregullorja për punën në institucionet edukativo-arsimore është trajtuar disa herë dhe janë bërë plotësimet e propozuara. Ai i sugjeroi drejtoreshës Arbërie Nagavci, që të përgatisë një raport me ndryshimet dhe ta prezantojë në Kuvend.

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimrregullorja për punën në institucionet edukativo-arsimore dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.**

### **Pika e trembëdhjetë**

**Caktimi i komisionit për përzgjedhjen e kryetarëve të Bashkësive lokale.**

**Kryesuesi** u shpreh se do të ishte mirë t'i kishim këtu emrat e propozuar për anëtarë të komisionit për përzgjedhjen e kryetarëve të Bashkësive lokale, mirëpo meqë nuk janë propozuar, atëherë për Kuvend të jenë emrat e propozuar.

**Qëndron Kastrati** propozoi që në komision të jetë shefi i Sektorit të BL-ve, një anëtar nga Kuvendi i Komunës dhe nga një prej katër partive që kanë përfaqësim më të madh në Kuvend.

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah caktimi i komisionit për përzgjedhjen e kryetarëve të Bashkësive lokale dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.**

### **Pika e katërbëdhjetë**

**Caktimi i anëtarëve të grupit punues për plotësimin dhe hartimin e Rregullores për bashkësi lokale.**

**Lirak Çelaj** sugjeroi që anëtarët e grupit punues për plotësimin dhe hartimin e Rregullores për bashkësi lokale, të caktohen nga ekzekutivi dhe të jenë ekspertë për këtë çështje.

**Kryesuesi** propozoi që nga një anëtarë të jetë nga partitë e mëdha, e të tjerët nga ekzekutivi.

**Agim Salihu** shprehu gatishmërinë që t'i ndihmojë këtij grupi punues në mënyrë vullnetare.

**Islam Pacolli** e përkrahu propozimin e dhënë nga z. Lirak Çelaj.

**Kryesuesi** konstatoi se njëzëri u përkrah heqja e kësaj pike nga rendi i ditës, por mbetet që **Agim Salihu**, bashkë me shefin e Zyrës ligjore, drejtorin e Drejtorisë së Administratës dhe përfaqësuesin e DEMOS-it, të punojnë në plotësimin dhe hartimin e Rregullores për bashkësi lokale, ta sjellin si projekt në Komitet, për ta shqyrtuar pastaj në Kuvend.

### **Të ndryshme**

**Lirak Çelaj** tha se më herët ishin të pajtimit që shefat e GP -ve dhe ekzekutivi me e mbajtur një takim me banorët e lagjes "Dodona" për t'i dëgjuar, në mënyrë që t'iu bëhet një zgjidhje këtyre banorëve, mirëpo një takim i tillë nuk është organizuar në mes të qytetarëve, ekzekutivit dhe shefave të GP-ve. Andaj është mirë të bëhet një zgjidhje për këtë çështje.

**Kryesuesi** tha se do të duhej takuar këta qytetarë dhe t'u tregohen opsionet e mundshme për zgjidhjen e kësaj çështjeje, mirëpo pa ekzekutivin kjo është e kotë.

**Qëndron Kastrati** dha sqarime lidhur me këtë çështje, duke u bazuar në takimet që i kanë mbajtur me këta qytetarë.

**Dardan Sejdiu** tha se është larg realitetit për zgjidhjen e problemit. Atyre ua kanë treguar tri opsionet e mundshme sipas bazës ligjore, mirëpo nuk janë pajtuar.

*Mbledhja përfundoi në orën 16:40.*

**Procesmbajtës:**  
**Zijadin Gashi dhe**  
**Shyhrete Islami**

**Kryesuesi i Komitetit**  
**Halim Halimi, jur. i dipl.**



